

VENDIM
Nr. 806, datë 12.12.2022

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË MAT TË PRONËS NR. 717,
ME EMËRTIM “SHTËPIA E USHTARAKËVE”, ME VENDNDODHJE NË
BURREL, ZONA KADASTRALE 1326, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR, DHE VENDIMIN NR. 771, DATË 14.11.2007, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHETETËRORE, QË
TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË BURREL,
TË QARKUT TË DIBRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 dhe 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Mat të pronës nr. 717, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje Burrel, zona kadastrale nr. 1326, sipas plan-rilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për realizimin e funksioneve administrative dhe shërbimeve në interes të komunitetit vendës dhe kryerjen e funksioneve të tjera sipas ligjit.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, hiqet prona nr. 717, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje Burrel, zona kadastrale nr. 1326, sipas plan-rilevimit, dhe shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 771, datë 14.11.2007, të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë Mat i ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, tjetërsimi dhe dhënia në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Mat dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
i pronës Nr. 717 "Shtëpia e Ushtarakëve" Burrel

PRONARI SHTET, MM, (Shtëpia Qendrore e FA)

DATË 12/09/2022

QËLLIMI Transferim

VENDNDODHJA

Bashkia Burrel

DVASHK Mat

Nr.Pasurisë 3/184

Z.K 1326

Indeksi i Hartës BU; F-5

TE DHËNAT E PASURISË

Lloji i pasurisë Trrall

Sip e pasurisë 1 645m²


Sip e gjurmës së ndërtimit 1 153m²

Nr. kateve _____ Nr. pemeve _____

Nord = 4608309.16
East = 501136.20

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord = 4608309.16
East = 501224.19



SHPJEGUESE:

Kufiri sipas Hartes Kadastrale
Sipërfaqja = 1645m²
Kufiri sipas gjendjes faktike
Sipërfaqja = 1645m²

Nord = 4608238.95
East = 501136.20

SH 1: 500

Nord = 4608238.95
East = 501224.19

NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI	I KUFIRIT	I KUFITARI	NIPT AGHIU
1	Vari			3/96		K51726024H
2	Lindje			3/94		
3	Jug			3/186		
4	Perëndim			3/96, 3/183		

REALIZOI PËR IGJIU

Topograf Ramiz Haxhiu

KONFIRMOI PËR IGJIU

DREJTORI March. Teuta KANXHERI

REALIZOI PËR ASHK

Specialisti

DVASHK

Nënshkrimi

KONFIRMOI

Përgjegjësi/Drejtori

Nënshkrimi/ Vula

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z, O, T

PËRCAKTIMI I KUFIRIT Sipas dokumentacionit arkivor dhe të pronësisë. Shënime; Ky planrilevim u hartua në zbatim të Faks-Mesazhit të SHSH të FA Nr. 264, datë 08.08.2022 bazuar në dokumentacionin hartografik arkivor, Certifikatës për Vërtetim Titulli "Në Përdorim", orto foto të vitit 2015-2016 e certifikuar nga ASIG-u.

PRONARI SHTET, MM (Shtëpia Qendrore e FA)

MIRATOHET

DREJTORI I SHTËPISË QENDRORE TE FA

Eduard SPAHIU

